




Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam

Department of Economy, Development and Tourism

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Administratë të përgjithshme  
Odeljenje za Opštu Upravu

## THIRRJE PËR APLIKIM

Nr. i prot. 2461 Më 24.07.2020  
Br. prot. Dt. 2020  
RAHOVEC - ORAHOVAC

### 1. Skema e grandeve "Zhvillimi i ndërmarrësisë në komunën e Rahovecit"

Komuna e Rahovecit me lansimin e skemës së grandeve për përkrahjen e zhvillimit të ndërmarrësisë do të ndihmojë në plotësimin e nevojave të të bërit biznes. Kjo skemë e grandeve do të mundësojë që projektet cilësore biznesore të implementohen dhe zhvillohen më tej, duke krijuar kështu vende të reja pune. Këto vende të reja të punës do të gjenerohen nga rritja e ndërmarrjeve ekzistuese që veprojnë në sektorët me potencial më të madhe për zhvillim.

### 2. Synimet e thirrjes për projekt propozim

**Synimi i përgjithshëm** i thirrjes është zhvillim socio-ekonomik komunal i balancuar përmes përkrahjes së zhvillimit të bizneseve në sektorin e zhvillimit ekonomik në komunën e Rahovecit.

**Synimet specifike** të kësaj ThPP janë:

- Krijimi i vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për gjininë femërore dhe të rinj
- Zhvillimi i ndërmarrësisë që kontribuon direkt në zhvillimin e sektorit të ekonomisë.

### 3. Përkrahja financiare e ofruar nga autoriteti kontraktues

Shuma e përgjithshme indikative për këtë thirrje është **20,000 €**. Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

Grandi do të jepet për:

Projekte biznesi (mikro ndërmarrje 1-9 punëtor)

**Shuma e grandit**

Vlera e grandit do të jetë deri në 1,000 €, ndërsa pjesa tjetër mbulohet nga përfituesi i grandit.

#### **4. Kualifikimi i aplikanteve: kush mund të aplikojë?**

Për t'u kualifikuar për grande, aplikanti/ja duhet:

- Të jenë shtetas të Kosovës, banor rezident i komunës së Rahovecit (dëshmohet me kopjet e letërnjoftimit),
- Aplikanti i përzgjedhur duhet që ligjërisht të themelojë biznesin në komunën e Rahovecit para nënshkrimit të Kontratës së grandit,
- Të jetë drejtpërdrejtë përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit,
- Bizneset e regjistruara duhet që të kenë të shlyera të gjitha obligimet ndaj Komunës së Rahovecit,
- Personat fizik që aplikojnë duhet të kenë të shlyera obligimet ndaj tatimit në pronë.

#### **5. Aplikantët që nuk kualifikohen**

Aplikantët potencial që nuk mund të marrin pjesë në ThPP janë të renditur si në vijim:

- Është shërbyes civil në ndonjë nga institucionet lokale ose qendrore të Kosovës,
- Është banor nga ndonjë komunë tjetër,
- Kanë bankrotuar apo janë në mbyllje, janë nën administrim të gjykatave,
- Kanë pezulluar aktivitetet afariste,

#### **6. Sektorët**

Përmes thirrjes aplikantët duhet të paraqesin **projekt-propozimin** për sektorët:

- **Prodhues dhe Përpunues të verërave**

#### **7. Lokacioni**

Projekti duhet të realizohet në territorin e komunës së Rahovecit.

#### **8. Formularët e aplikimit**

Aplikantët duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit duke përdorur formularin e aplikimit të ofruar nga autoriteti kontraktues të bashkangjitur në këtë thirrje.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

**-Nëse aplikuesi është person fizik:**

- Formulari i aplikimit
- ID e aplikuesit
- Projekt Propozimi
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Konfirmimi për llogari bankare

**-Nëse aplikuesi është person juridik:**

- Formulari i aplikimit
- Projekt Propozimi
- Certifikata e biznesit (informata për biznesin)
- ID e pronarit
- Vërtetim që i ka të shlyera obligimet ndaj Komunës së Rahovecit
- Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së
- Konfirmimin e xhirollogarisë bankare

## **9. Kriteret dhe vlerësimi**

- Të jetë biznes i regjistruar (aktiv ne ARBK),
- Të ketë të deklaruar së paku 1 e më shumë punëtor brenda vitit 2020 (dëshmi e ATK-së)

Vlerësimi i aplikacioneve do të përfshijë kontrollin administrativ, kontrollin e kualifikueshmërisë dhe vlerësimin final. Procesi i kontrollit teknik do të vlerësoj nëse aplikuesi ka paraqitur dokumentet e kërkuara me këtë udhëzues, kontrolli i kualifikueshmërisë do të vlerësoj nëse aplikuesi ka respektuar kriteret e kualifikueshmërisë dhe vlerësimi final i cili do të vlerësoj në bazë të kriterëve për vlerësim. Grandi do ti jepet aplikanteve (me notë më të lartë), deri në kufijtë e buxhetit në dispozicion.

## **10. Shpenzimet e pranueshme**

Llojet vijuese të aktiviteteve në përputhje me synimet e THPP llogariten si **shpenzime të kualifikueshme**:

- Investimet në asete të prekshme që kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, makinerisë, linjat e prodhimit, përmirësimin e proceseve dhe metodave prodhuese;

## **11. Mënyra e aplikimit**

Aplikacioni mund të shkarkohet në WEB-faqen e Komunës së Rahovecit, ose të tërhiqet në zyrat e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

**Aplikacioni i plotësuar duhet dorëzuar në adresën:**

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ,Komuna e Rahovecit  
Rr. Dëshmorët e Pashtrikut p.n.

Zyrtarja përgjegjëse : **Znj.Saranda Shala**  
**+383 49/471-787**

## **12. Afati për dorëzimin e aplikacionit të plotë.**

Afati për dorëzimin e aplikacionit është nga: 27 korrik deri me 27 gusht 2020.